



Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-067, mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të datës 21 maj 2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-034.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës ka jurisdiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.



Parashtrimi i ankesave duhet të bëhet brenda afateve të parapara ligjore, përndryshe ankesat nuk do të shqyrtohen.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Informata
të përgjithshme

Kualifikueshmëria
e punëtorëve për të
drejtën në 20%

A KUALIFIKOHENI PËR 20%?

1. A jeni apo keni qenë i regjistruar si punëtorë i ndërmarrjes në kohën e privatizimit?
2. A keni qenë në listën e pagave për jo më pak se tri (3) vite?

Nëse përgjigja juaj është "PO" në dy pyetjet e radhitura më lartë, dhe nëse nuk keni arritur moshën e pensionit deri në datën e privatizimit të NSH-së, atëherë ju kualifikoheni për përfitimin e 20%.

LISTAT FILLESTARE

Duhet pasur parasysh se listat me emrat e përfituesve të 20% përgatiten nga Organi përfaqësues i të punësuarve të NSH-së që privatizohet (Drejtori, Kryetari i Këshillit të Punëtorëve dhe Kryetari i Organizatës Sindikale të NSH-së), në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës në baza jo diskriminuese dhe i dërgohen Agjencisë (Ref. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 - me ndryshime).

Nëse organi përfaqësues i të punësuarve nuk ekziston më, atëherë Federata e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, harton listën në bazë të dëshmime të dokumentuara në baza jo-diskriminuese dhe të njëjten ia dërgon Agjencisë. (Ref. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/45)

Kjo listë përgatitet në bazë të dokumentacionit në dispozicion dhe nënshkruhet nga personat e lartëpërmendur.

Nëse i keni plotësuar kriteret më lartë por emri juaj nuk ndodhet në listë, ju keni të drejtë që pas publikimit të listës fillestare, të parashtroni ankesë ose të kundërshtoni një ose më shumë emra të personave që gjenden në listën fillestare, pranë Komisionit të AKP-së për shqyrtimin e ankesave në afat prej 20 ditësh nga data e fundit e publikimit të listës në gazetën ditore në gjuhën shqipe dhe serbe.

LISTAT FINALE

Pas publikimit të listës finale, nëse personi nuk gjendet në listë, ka të drejtë të parashtror ankesë ose të kundërshtoj një ose më shumë emra të personave që gjenden në listën finale, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përfundimisht, kriteret e lartëpërmendura nuk i ndalojnë punëtorët që pretendojnë se do të kishin qenë të regjistruar apo të punësuar, po të mos kishin qenë të diskriminuar, dhe mund të parashtror ankesën në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

FONDET

Shuma e fondeve në dispozicion për t'u shpërndarë transferohet në një llogari të veçantë në BSPK, në përputhje me nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime), nga e cila pastaj shumat individuale u shpërndahen punëtorëve të kualifikueshëm në llogarit e tyre personale.

Në këtë fazë, punëtorët e kualifikueshëm duhet që BSPK-së t'i dërgojnë një kopje të llogarisë së hapur në njërin nga bankat që funksionojnë në Kosovë dhe kopjen e letërnjoftimit.

Duke filluar prej vitit 2004 deri në fund të vitit 2019, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka arritur të shpërndaj shumën prej €133,362,547.48 tek punëtorët e kualifikueshëm për përfitimin e 20%. Ndërsa numri i përgjithshëm i punëtorëve që përfituan nga 20% i të ardhurave nga procesi i privatizimit është 57,316 ish punëtorë të Ndërmarrjeve Shoqërore.

